



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

02-060/01-0042000-13/26

29.07.2026



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0042000-13/26 dt. 29.07.2026

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 2, pika c, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenit 13, paragrafi 1, pika 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 3 paragrafi 1, 2 dhe 5 i Rregullores Komunale Nr. 08/2023 Për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe granteve; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.07.2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0041998-13/26 dt. 28.07.2026); sjell këtë:

VENDIM

Për mbështetje financiare (subvencionim) të viktimave të dhunës gjatë vitit 2026

1. MIRATOHET Vendimi për mbështetje financiare të viktimave të dhunës gjatë vitit 2026
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi viktimat dhunës gjatë vitit 2026 mbështeten financiarisht në vlerë prej 250.00 (dyqindpesëdhjetë) € euro, nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere – Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
3. Mbështetja financiare sipas pikës 2 të këtij vendimi bëhet me qëllim të mbrojtjes dhe përkrahjes së kësaj kategorie të cenueshme dhe nevojën për mbështetje institucionale të viktimave të dhunës në komunë, si ndihmë emergjente dhe sociale për personat që kanë përjetuar dhunë dhe nevojën për të përballuar nevojat bazike në procesin e stabilizimit dhe riintegritimit social.
4. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij vendimi do të barten në xhirollogarinë e personave të prekur, viktimave të dhunës arsyetohet dhe vërtetohet mbi bazën e të dhënave zyrtare të ofruara nga Qendra për punë sociale në bashkëpunim me Qendrën për mbrojtjen e grave dhe FËMIJËVE “Raba Voca”.
5. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

[Signature]
KAMBERI

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit

1 x 1 MAPL-së

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

DBF-së, DMS-së